



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3698/ 7 prot

Datë 01.04.2026

V E N D I M
Nr. 455/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.04.2026 me

Objekt:

Testimin e mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution”, “Kristalina KH” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK, dhe në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr REF-65489-10-17-2025, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, me fond limit 47,298,660 (dyzet e shtatë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, ose 489,077.24 (katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë njëzet e katër) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 17.10.2025 është 96.71 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Subjekte të interesuar:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Operatori ekonomik “Adel Co” SHPK me NIPT L22117021M
me adresë: Rruga “Efendiu”, Nr. 13, Tiranë.

Operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK me NIPT J72124001N, me adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, Km 10, Tiranë.

Operatori ekonomik “*Kristalina KH*” SHPK me NIPT K11501002D, me adresë: Rruga “Lord Bajroni”, Laprakë, ose Pasuria nr. 178, Zonë Kadastrale 3319, Shargë, Tiranë.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK me NIPT L01524018M me adresa: Lagjia “Qafe Kashar”, Ndertese Private Nr. 5, Autostrada Tiranë - Durrës, km 6, Tiranë.

Operatori ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK me NIPT J62426002Q me adresa: Autostrada Tirane - Durres, Km. 8, Kodër Kashar, Tiranë.

Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial.
Adresa: Rruga “Muhamet Gjollesha”, Nr. 56, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, neni 19/1 e vijues, Ligji nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996 “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

I.1. Në datën 20.10.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr REF-65489-10-17-2025, me objekt “*Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme*”, me fond limit 47,298,660 (dyzet e shtatë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, ose 489,077.24 (katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë njëzet e katër) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 17.10.2025 është 96.71 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

I.2. Në datën 20.11.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

I.3. Në datën 10.12.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Marketing & Distribution” SHPK	23,195,518	lekë	kualifikuar
2. “Kristalina KH” SHPK	24,876,307	lekë	kualifikuar
3. BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK	29,927,700	lekë	kualifikuar
4. “InfoSoft Office” SHPK	30,276,961.70	lekë	kualifikuar
5. “Adel Co” SHPK	35,474,710	lekë	kualifikuar
6. “Albdesign PSP” SHPK	36,176,020	lekë	kualifikuar

I.4. Në datën 18.12.2025, është publikuar Njoftimi i Fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik, ku fitues rezulton operatori ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK

I.5. Në datën 29.12.2025, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar me numër elektronik ankimi A/2025/6218 dhe me nr. 3717/2025 protokoli, datë 29.12.2025 e operatorit ekonomik “*Adel Co*” SHPK për procedurën e “*Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar*”, me Nr REF-65489-10-17-2025, me objekt “*Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme*”, me fond limit 47,298,660 (*dyzet e shtatë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë*) lekë pa TVSH, ose 489,077.24 (*katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë njëzet e katër*) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 17.10.2025 është 96.71 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kundërshtimin e kualifikimit të operatorëve ekonomikë “*Marketing & Distribution*” SHPK, “*Kristalina KH*” SHPK, BOE “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK dhe “*Infosoft Office*” SHPK. Në mënyrë të përmbledhur pretendohet:

Duke qene se modelet e dorezuara nga firmat “Marketing & Distribution”, firma “Kristalina KH”, BOE “Office Paper” & “Inpress” dhe “Infosoft Office”, ne kete tender nuk jane sipas specifikimeve teknike kerkojme te behet analiza e tyre, pra e kutise dhe e dosjes ne nje laborator te akredituar per:

- 1. Gramaturen,*
- 2. pH-in,*
- 3. Matjen e permasave fizike te modeleve, dhe gjithashtu matjen e hapesirave nga rreshti ne rresht, vijezimet, te percaktohet lloji i shkrimit, matja e kornizimit nga border line ne limitin e dosjes*
- 4. Analizen per percaktimin e ngjyres.*

I.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3717/1 prot., datë 29.12.2025 me kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “*Adel Co*” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomik “*Marketing & Distribution*” SHPK, “*Kristalina KH*” SHPK, BOE “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK dhe “*Infosoft Office*” SHPK.

I.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nr. 3717/2 prot, datë 30.12.2025 nga operatori ekonomik i interesuar “*Marketing & Distribution*” SHPK sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”.

I.8. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se pranë Komisionit Prokurimit Publik është depozituar formulari i paraqitjes së argumenteve nr. 3717/3 prot, datë 30.12.2025 nga operatori ekonomik i interesuar BOE “*Office Paper*” SHPK & “*Inpress*” SHPK sipas parashikimeve në nenin 113 ligji Nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”.

I.9. Nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike, autoriteti kontraktor ka dërguar shkresën nr. 3087/15 prot., datë 08.01.2026, me objekt “*Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-65489-10-17-2025, me objekt Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme*” e cila është protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 3717/4 prot, datë 08.01.2026 si dhe shkresën nr. 3087/15 prot., datë 08.01.2026, me objekt “*Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Adel Co” SHPK, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr. REF-65489-10-17-2025, me objekt Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme*” ardhur nëpërmjetë shërbimit postar e cila është protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 3717/5 prot, datë 12.01.2026, bashkalidhur së cilës ndodhet akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Adel Co*” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton se autoriteti kontraktor me vendimin nr. 05/2026, datë 08.01.2026, ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

I.10. Me shkresën nr. 08 prot, datë 16.01.2026, me objekt “*Në përgjigje të vendimit nr. 05/2026 të Autoritetit Kontraktor “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” për ankesën e shoqërisë “Adel Co” shpk me numër aplikimi online A/2025/6218 datë 29.12.2025 me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme” REF-65489-10-17-2025*”, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me nr. 3717/6 prot, datë 20.01.2026 operatori ekonomik ankimues “*Adel Co*” SHPK ka paraqitur argumenta kundër vendimit të KSHA të autoritetit kontraktor.

I.11. Me shkresën nr. 3717/7 prot., datë 18.02.2026 me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie e mostrave KPP-së lidhur me ankesat e operatorit ekonomik “Kristalina KH” SHPK, “Adel Co” SHPK dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK” Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua autoritetit kontraktor duke i kërkuar informacion si vijon:

Pranë Komisionit të Prokurimit Publik, janë paraqitur ankesat e operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK me nr. elektronik A/2025/6226 datë 19.12.2025 dhe me numer 3732/2025 prot, datë 29.12.2025; “Kristalina KH” SHPK me nr. elektronik A/2025/6209 datë 24.12.2025 dhe me numer 3698/2025 prot, datë 24.12.2025; “Adel Co” SHPK me nr elektronik A/2025/6218 datë 29.12.2025, dhe me nr. 3717/2025 datë 29.12.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, Marrëveshje Kuadër me një operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 4 (katër) vjeçar” me Nr. REF-65489-10-17-2025, me fond limit: 47,298,660 (dyzet e shtatë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, ose 489,077.24 (katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë njëzet e katër) euro pa TVSH., kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 17.10.2025 është 96.71 lekë, zhvilluar në datën 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”, Komisioni i Prokurimit Publik publikoi kriteret për të cilat operatorët ekonomik ankimes pretendojnë se nuk përmbushen nga pjesëmarrësit në këtë procedurë.

Referuar nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti kontraktor ose enti kontraktor” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë: a) pranimin e plotë të ankesës; b) pranimin e pjesshëm të ankesës; c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të

punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

*Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor është dërguar vetëm akti i trajtimit të ankesës së operatorëve ekonomikë ankimes. Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik së bashku me fletën e inventarit të dokumentave si dhe vulën përkatëse të institucionit në cdo fletë, vetëm dokumentacionin e dorëzuar pranë jush nga operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK në lidhje me vërtetueshmërinë e deklaramëve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit shtojca 10, ashtu sikurse përcaktohet në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklaramin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.** Në Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pika 5 “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre; b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit”.*

*Gjithashtu me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, **Mostrat** e paraqitura nga operatorët ekonomikë, “Marketing & Distribution” SHPK, “Kristalina KH” SHPK, bashkimit të operatorëve ekonomikë “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK, “Infosoft Office” SHP” dhe “Adel Co” SHPK për këtë procedurë prokurimi, së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre, si dhe procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e mostrave.*

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i sipërcituar të dorëzohet pranë KPP-së, brenda ditës së mërkurë datë 20.02.2026.

I.12. Me shkresën nr. 3087/18 prot., datë 24.02.2026, me objekt: “Dërgim i dokumentacioni dhe dorëzim i mostrave” protokolluar me tonën me shkresën nr. 3717/8 prot, datë 24.02.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin e kërkuar si dhe mostrat e operatorëve ekonomikë.

I.13. Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatori ekonomik, në datën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit duhet të paraqesë nga një mostër për artikujt e listuara më poshtë, në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 6.

1 (një) kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm

1 (një) dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm

Mungesa e mostrës është kusht për skualifikim.

Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” sh.a në datën dhe orën e hapjes së tenderit, me adresë: Rr “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

I.14. Në shtojcën 6 “Formulari i Specifikimeve Teknike” të modifikuar të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet si më poshtë:

Specifikimet Teknike sipas Vendimit Nr. 7, Datë 09.09.2024 Të KLA “Për Miratimin e Standardeve të Kutive dhe Dosjeve për Ruajtje të Përhershme, për Arkivat jo në Veprim, si dhe për Institucionet që Administrojnë Dokumente të Tipologjisë, ose që ruajnë Dokumentacion Gjithnjë pranë tyre”.

Lloji	Përmasat	Specifikimet teknike
Kuti për ruajtje të përhershme	40x28x18	<u>Kutia:</u> - Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm, me gramaturë së paku 615 g/m ² që të lejojë valëzueshmërinë, duke mos cenuar përmasat e kutisë. - Faqet anësore të jenë me dy shtresa kartoni (fortësi të dyfishtë), ndërsa faqet e tjera me një shtresë kartoni. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit.
Kuti për ruajtje të përhershme për amza	40x55x18	
Kuti për ruajtje të	40x70x9	

përshërshme për regjistra		<ul style="list-style-type: none"> - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin. - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar).
Dosje për ruajtje të përshërshme	36x24	<ul style="list-style-type: none"> - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. - Ngjyra e kutisë të jetë gri e hapur ndërmjet kodeve; Pantone 427c-429c - Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm. <p><u>Dosja:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Kartoni të jetë së paku me gramaturë 325 gr/m², duke mos cenuar përmasat e dosjes, me 2 krahë të brendashkruar të palosur, pjesa frontale me kthim pa ngjitje. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5. - Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin - Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e pastruar). - Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura. - Ngjyra e dosjes duhet të jetë e njëjtë me ngjyrën e kutisë. - Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm

I.15. Me shkresën 3717/9 prot., datë 05.03.2026 me objekt “Kërkesë për Informacioni” Komisioni i Prokurimit Publik kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Në kuadër të shqyrtimit të ankesave të paraqitura për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesa. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor përsa i përket specifikimeve teknike të artikujve Kuti dhe Dosje për ruajtje të përshërshme.

Sa më sipër, bazuar në nenin 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij, si dhe në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe ligjit Nr. 116 datë 11.09.2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, duke qenë se, ju jeni institucioni kompetent i caktuar me ligj të posaçëm në fushën e akreditimit, si dhe në cilësinë e institucionit përgjegjës, për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë të ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i

prokurimit publik, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga institucioni juaj si më poshtë vijon:

1- A ka laboratorë privat ose shtetërorë në Republikën e Shqipërisë të akredituar nga institucioni juaj për kryerjen e analizave për komponentët e mëposhtëm:

- Gramaturë.
- pH.
- Rezervë alkaline.
- Lignin.
- Ngjyrën e kutisë/dosjes gri e hapur ndërmjet kodeve pantone 427c - 429c.
- Matjen e përmasave të kutisë (40x28x18) cm.
- Matjen e përmasave të dosjes (36x24) cm.
- Matjen e hapësirave nga rreshti në rresht, vijëzimet, llojin e shkrimit, matjen e kornizimit nga border line në limitin e dosjes.

2- Në rast se ka laboratorë të akredituar nga ana juaj cilët janë këto laboratorë dhe për cilin nga komponentët e sipërcituar janë të akredituar nga ana juaj për të kryer analiza.

Për sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj maksimal, korrekt dhe eficient. Afati për kthimin e përgjigjes suaj është brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijëni e kësaj shkresë, pasi informacioni juaj është i rëndësishëm për marrjen e një vendimi të drejtë nga ana jonë.

Bashkalidhur shkresës do të gjeni shtojcën e specifikimeve teknike.

I.16. Me shkresën 180/7 prot., datë 10.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 3717/10, datë 13.03.2026 me objekt “Kthim përgjigje”, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, na informon si më poshtë vijon:

Në përgjigje të shkresës suaj, Nr. 3717/9 Prot, datë 05.03.2026, “Kërkesë për informacion”, lidhur me laboratorë e akredituar në Republikën e Shqipërisë për kryerjen e analizave për artikujt “Kuti dhe dosje për ruajtje të përherëshme”, ju informojmë se pas verifikimit të fushës së akreditimit të laboratorëve testues sipas standartit S SH EN ISO/IEC 17025:2017, rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit “DPA” ka akredituar disa laboratorë testues që kryejnë analiza për parametra të ndryshëm të letrës dhe kartonit, si më poshtë:

1- ECCAT

Laboratori kryen analiza për këta parametra të letrës/kartonit: 1- Gramatura, 2- pH, 3- Trashësi, 4- Volumi specifik, 5- Densitet, 6- Bardhësi CIE (C/2o) në kushtet e ndriçimit të brëndëshëm.

2- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

Laboratori kryen analiza për këta parametra të letrës/kartonit: 1- pH, 2- Gramatura, 3- Densitet, 3- Volumi specifik dhe Trashësi.

3- Inspektorati Shtetëror Teknik Dhe Industrial

Laboratori kryen analiza për këta parametra të letrës/kartonit: 1- Lagështi, 2- Përmasat, 3- Trashësi, 4- Opaciteti. 5- pH, 6- Gramatura, 7- Volumi specifik dhe densitet.

4. Eko-Studio-Projekt

Laboratori kryen analiza për këta parametra të letrës/kartonit: 1- Densiteti, 2- Trashësia, 3- Volumi specifik, 4- Gramatura, 5- Bardhësia, 6- pH, 7- Lagështia dhe opaciteti.

Sa i përket parametrave të tjerë të përmendur në shkresën tuaj (si p.sh rezervë alkaline, lignin, ngjyra sipas kodeve Paneton, etj), ju bëjmë me dije se Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nuk ka aktualisht laboratorë të akredituar për kryerjen e këtyre analizave.

Fusha e detajuar e akreditimit për secilin nga laboratorët e sipërpërmendur mund të gjëndet në faqen zyrtare të DPA-së, ëëë.dpa.gov.al.

I.17. Me shkresën nr. 3717/11 prot., datë 17.03.2026 me objekt “Kërkesë për Informacion” Komisioni Prokurimit Publik kërkoi Informacion nga laboratorit testues “Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave” SHPK si më poshtë vijon:

Në kuadër të shqyrtimit të ankesave të paraqitura për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesa. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor përsa i përket specifikimeve teknike të artikujve Kuti dhe Dosje për ruajtje të përhershme.

kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm

dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm

Me shkresën nr. 3717/9 prot., datë 05.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, informacion në lidhje me laboratorët e akredituar për testimin e letrës dhe kartonit, për komponentët 1- Gramaturë;, - pH;, 2- Rezervë alkaline;, 3- Lignin;, 4- Ngjyrën e kutisë/dosjes gri e hapur ndërmjet kodeve pantone 427c - 429c;, 5- Matjen e përmasave të kutisë (40x28x18) cm;, 6- Matjen e përmasave të dosjes (36x24) cm ;, 7- Matjen e hapësirave nga rreshti në rresht, vijëzimet, llojin e shkrimit, matjen e kornizimit nga border line në limitin e dosjes;. Me shkresën nr. 180/7 prot, datë 10.03.2026 me objekt “Kthim përgjigje” Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon Komisionin e Prokurimit Publik se Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ka akredituar disa laborator testues që kryejnë analizat për parametra të ndryshëm të letrës dhe kartonit, ku ndër ta është dhe laboratorit i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave i cili është i akredituar për kryerjen e analizave të këtyre parametrave: 1- pH, 2- Gramaturë, 3- Densitet, 4- Volumi specifik dhe trashësia.

Sa më sipër, bazuar në nenin 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij, si dhe në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga ana juaj si më poshtë vijon: 1- Subjekti juaj mund të kryejë analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet 1- pH; 2- Gramaturë; 3- Densitet; 4- Volumi specifik dhe trashësia. 2- Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifat e analizave për secilin komponentë të sipërcituar.

Për sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj maksimal, korrekt dhe eficient. Afati për kthimin e përgjigjes suaj është brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese, pasi informacioni juaj është i rëndësishëm për marrjen e një vendimi të drejtë nga ana jonë.

I.18. Me shkresën nr. 3717/12 prot., datë 17.03.2026 me objekt “Kërkesë për Informacion” Komisioni Prokurimit Publik kërkoi Informacion nga laboratorit testues “Eko-Studio-Projekt” SHPK si më poshtë vijon:

Në kuadër të shqyrtimit të ankesave të paraqitura për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesa. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor përsa i përket specifikimeve teknike të artikujve Kuti dhe Dosje për ruajtje të përhershme.

*kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm
dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm*

Me shkresën nr. 3717/9 prot., datë 05.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, informacion në lidhje me laboratorët e akredituar për testimin e letrës dhe kartonit, për komponentët 1- Gramaturë; - pH; 2- Rezervë alkaline; 3- Lignin; 4- Ngjyrën e kutisë/dosjes gri e hapur ndërmjet kodeve pantone 427c - 429c; 5- Matjen e përmasave të kutisë (40x28x18) cm; 6- Matjen e përmasave të dosjes (36x24) cm ; 7- Matjen e hapësirave nga rreshti në rresht, vijëzimet, llojin e shkrimit, matjen e kornizimit nga border line në limitin e dosjes; Me shkresën nr. 180/7 prot, datë 10.03.2026 me objekt “Kthim përgjigje” Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon Komisionin e Prokurimit Publik se Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ka akredituar disa laborator testues që kryejnë analizat për parametra të ndryshëm të letrës dhe kartonit, ku ndër ta është dhe laborator i EKO-STUDIO-PROJEKT i cili është i akredituar për kryerjen

e analizave të këtyre parametrave: 1- Gramaturë, 2- pH, 3- Trashësi, 4- Volumi specifik, 5- Densitet, 6- Bardhësi, 7- Lagështi dhe opacitet.

Sa më sipër, bazuar në nenin 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij, si dhe në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga ana juaj si më poshtë vijon: 1- Subjekti juaj mund të kryejë analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet 1- pH,; 2- Gramaturë,; 3- Densitet,; 4- Volumi specifik,; 5- Trashësi,; 6- Bardhësi,; 7- Lagështi dhe opacitet. 2- Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifat e analizave për secilin komponentë të sipërcituar.

Për sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj maksimal, korrekt dhe eficient. Afati për kthimin e përgjigjes suaj është brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese, pasi informacioni juaj është i rëndësishëm për marrjen e një vendimi të drejtë nga ana jonë.

I.19. Me shkresën nr. 3717/13 prot., datë 17.03.2026 me objekt “Kërkesë për Informacion” Komisioni Prokurimit Publik kërkoi Informacion nga laboratorit testues “Inspektoria Shtetëror Teknik dhe Industrial” SHPK si më poshtë vijon:

Në kuadër të shqyrtimit të ankesave të paraqitura për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesa. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor përsa i përket specifikimeve teknike të artikujve Kuti dhe Dosje për ruajtje të përhershme.

*kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm
dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm*

Me shkresën nr. 3717/9 prot., datë 05.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, informacion në lidhje me laboratorët e akredituar për testimin e letrës dhe kartonit, për komponentët 1- Gramaturë,; - pH,; 2- Rezervë alkaline,; 3- Lignin,; 4- Ngjyrën e kutisë/dosjes gri e hapur ndërmjet kodeve pantone 427c - 429c,; 5- Matjen e përmasave të kutisë (40x28x18) cm,; 6- Matjen e përmasave të dosjes (36x24) cm ;, 7- Matjen e hapësirave nga rreshti në rresht, vijëzimet, llojin e shkrimit, matjen e kornizimit nga border line në limitin e dosjes,; Me shkresën nr. 180/7 prot, datë 10.03.2026 me objekt “Kthim përgjigje” Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon Komisionin e

Prokurimit Publik se Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ka akredituar disa laborator testues që kryejnë analizat për parametra të ndryshëm të letrës dhe kartonit, ku ndër ta është dhe laboratorit i INSPEKTORATIT SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL i cili është i akredituar për kryerjen e analizave të këtyre parametrave: 1- Gramaturë, 2- pH, 3- Trashësi, 4- Volumi specifik dhe densitet, 5- Opecitet, 6- Lagështi, 7- Përmasat.

Sa më sipër, bazuar në nenin 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij, si dhe në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga ana juaj si më poshtë vijon: 1- Subjekti juaj mund të kryejë analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet 1- pH; 2- Gramaturë; 3- Volumi specifik dhe densitet; 4- Trashësi; 5- Opecitet; 6- Lagështi; 7- Përmasat. 2- Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifat e analizave për secilin komponentë të sipërcituar.

Për sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj maksimal, korrekt dhe eficient. Afati për kthimin e përgjigjes suaj është brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese, pasi informacioni juaj është i rëndësishëm për marrjen e një vendimi të drejtë nga ana jonë.

I.20. Me shkresën nr. 3717/14 prot., datë 17.03.2026 me objekt “Kërkesë për Informacion” Komisioni Prokurimit Publik kërkoi Informacion nga laboratorit testues “Eccat Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK si më poshtë vijon:

Në kuadër të shqyrtimit të ankesave të paraqitura për një procedurë prokurimi, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e kryerjes së procedurës së hetimit administrativ, lidhur me pretendimet e ngritura në ankesa. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave konstatohen pretendime lidhur me përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor përsa i përket specifikimeve teknike të artikujve Kuti dhe Dosje për ruajtje të përhershme.

kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm

dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm

Me shkresën nr. 3717/9 prot., datë 05.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, informacion në lidhje me laboratorët e akredituar për testimin e letrës dhe kartonit, për komponentët 1- Gramaturë; - pH; 2- Rezervë alkaline; 3- Lignin; 4- Ngjyrën e kutisë/dosjes gri e hapur ndërmjet kodeve pantone 427c - 429c; 5- Matjen e përmasave të kutisë (40x28x18) cm; 6- Matjen e përmasave të dosjes

(36x24) cm ; 7- Matjen e hapësirave nga rreshti në rresht, vijëzimet, llojin e shkrimit, matjen e kornizimit nga border line në limitin e dosjes; Me shkresën nr. 180/7 prot, datë 10.03.2026 me objekt “Kthim përgjigje” Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon Komisionin e Prokurimit Publik se Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA) ka akredituar disa laborator testues që kryejnë analizat për parametra të ndryshëm të letrës dhe kartonit, ku ndër ta është dhe laboratori i ECCAT ENVIRONMENTAL CONSULTING, CHEMICAL ANALYSIS & TESTING i cili është i akredituar për kryerjen e analizave të këtyre parametrave: 1- Gramaturë, 2- pH, 3- Trashësi, 4- Volumi specifik, 5- Densitet, 6- Bardhësi CIE (C/2o) në kushtet e ndriçimit të brëndëshëm.

Sa më sipër, bazuar në nenin 24 pika 1 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij, si dhe në zbatim të nenit 115/1 e vijues të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, neneve 71, 72, 73 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, Komisionit të Prokurimit Publik i shfaqet nevoja e një informacioni nga ana juaj si më poshtë vijon: 1- Subjekti juaj mund të kryejë analizat e materialeve (kuti dhe dosje) për përbërjet 1- pH, 2- Gramaturë, 3- Densitet, 4- Volumi specifik, 5- Trashësi, 6- Bardhësi CIE (C/2o) në kushtet e ndriçimit të brëndëshëm. 2- Nëse po na informoni mbi kostot apo tarifën e analizave për secilin komponentë të sipërcituar.

Për sa më sipër, kërkojmë bashkëpunimin tuaj maksimal, korrekt dhe eficient. Afati për kthimin e përgjigjes suaj është brenda 2 (dy) ditëve nga marrja dijeni e kësaj shkrese, pasi informacioni juaj është i rëndësishëm për marrjen e një vendimi të drejtë nga ana jonë.

I.21. Me shkresën nr. 3111/1 prot., datë 19.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 3717/15, datë 24.03.2026 me objekt “Kthim-përgjigje kërkesës për informacion nr. 3717/11 prot, datë 17.03.2026”, laboratori testues “Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave”, informon si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të kërkesës suaj nr. 3717/11 prot., datë 17.03.2026 protokolluar me tonën nr. 3111 prot, datë 19.03.2026, “Kërkesë për informacion”, ju bëjmë me dije se, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave më datë 09.04.2024, është akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit sipas Certifikatës së Akreditimit nr. L 129 Laborator Testues, në përputhje me standartin SSH ISO/IEC 17025:2017, për kryerjen e analizës së: 1- pH, 2-Gramaturë, 3- Densitet, 4- Volumi specifik dhe trashësia.

Në lidhje me çfarë parashtroni në shkresën tuaj, për të kryer analizat e materialeve kuti dhe dosje për parametrat 1. pH, 2. Gramaturë, 3- Densitet, 4- Volumi specifik dhe trashësia, ju

informojmë se, ne si institucion jemi të akredituar për kryerjen e të gjitha komponentëve të sipërpërmendur.

Gjithashtu, për sa i përketë ofrimit të shërbimit të kërkuar, tarifa e analizave për secilën nga këto komponentë është 1,500 (një mijë e pesëqind) lekë. Afati i përgjigjes për secilën analizë është 4 (katër) ditë pune.

I.22. Me shkresën nr. 389 prot., datë 19.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 3717/16 prot, datë 24.03.2026 me objekt “Kthim-përgjigje informacion mbi akreditimin dhe analizat për letër/karton”, laboratorit testues “Eccat Environmental Consulting, Chemical Analysis & Testing” SHPK, informon si më poshtë vijon:

Në vijim të shkresës suaj me numër protokollit 3717/12, ju informojmë se shoqëria ECCAT është e akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit me Numër Akreditimi: LT: 128, për kryerjen e analizave laboratorik për materialet letër/karton/pulpë, sipas parametrave dhe metodave si më poshtë: Gramatura, pH, Trashësia, vëllim specifik, Densiteti, Përcaktimi i bardhësisë CIE, C/2o (në kushtet e ndriçimit të brendëshëm). Gjithashtu, ju bëjmë me dije se shoqëria jonë është e akredituar edhe për kryerjen e analizave në fushat e mëposhtme: Analiza uji, Analiza ajrit në mjedisë, Matje të zhurmave në mjedis dhe në vendin e punës, Analiza të gazeve në mjedis dhe gazeve në oxhak, Matje të vibrimeve, Analiza ushqimore, Analiza të detergjentëve. Ne vijim, ju informojmë se oferta jonë për analizimin e parametrave të kërkuara nga ana juaj është e bashkangjitur kësaj shkrese, sipas kërkesës suaj.

Nr.	Testi/Parametri	Çmimi ALL pa TVSH/Parametër	Numri i mostrave	Cmimi total ALL pa TVSH
1	Gramatura	5580	1	5580
2	pH	6210	1	6210
3	Trashësia	2100	1	2100
4	Volumi specifik	2100	1	2100
5	Densiteti	2100	1	2100
6	Përcaktimi i bardhësisë CIE, C/2o (në kushtet e ndriçimit të brendëshëm).	4320	1	4320
Cmimi total ALL pa TVSH				22,410
Cmimi total ALL me TVSH				26,892

I.23. Me shkresën nr. 2835/1 prot., datë 24.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 3717/17 prot, datë 25.03.2026 me objekt “Kthim-përgjigje”, laboratorit testues “Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial” SHPK, informon si më poshtë vijon:

Në përgjigje të kërkesës tuaj me Prot/hyrës Nr. 2835, datë 19.03.2026, ju bëjmë me dije se në Laboratorin e tekstileve pranë Inspektoriatit Shtetëror teknik dhe Industrial, kryhen testimet për letër/karton për këto tregues: 1- Gramaturë, 2- pH, 3- Trashësi, 4- Volumi specifik, 5- Densitet, 6- Opacitet, 7- Lagështi, 8- Përmasat. Të gjithë treguesit janë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit DPA. Kostot për testimin e një kampioni letër/karton, ku përfshihen të gjithë treguesit e sipër përmendur është 9000 (nëntë mijë) lekë.

I.24. Me shkresën nr. 288 prot., datë 25.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 3717/18 prot, datë 27.03.2026 me objekt “Kthim-përgjigje shkresës me Nr. 3717/12 prot, datë 17.03.2026”, laboratorit testues “Eko-Studio-Projekt” SHPK, informon si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 3717/12 prot., datë 17.03.2026, me lëndë “Kërkesë për Informacion”, drejtuar pranë zyrës sonë, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

Eko-Studio-Projekt ShPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikas dhe kryhet testimet permanent dhe me kampione të komponentëve të Ujit, të Tokës, të Ajrit (Pluhurit, Gazrave helmuese dhe industriale) të Mikroklimës, të Zhurmave, Radioaktivitetit, Letrës, Kartonit, Plastikës, Tekstilit dhe Produkteve Kimike.

Oferta ekonomike është si më poshtë vijon:

Nr.	Shërbim	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi pa TVSh
1	Analiza e pH-it	Copë/një testim	1	6800
2	Analiza e gramaturës	Copë/një testim	1	6000
3	Përcaktimi i Densitetit	Copë/një testim	1	4540
4	Analiza e Trashësisë	Copë/një testim	1	4970
5	Përcaktimi i Volumit specifik	Copë/një testim	1	4140
6	Përcaktimi i Bardhësisë	Copë/një testim	1	5500
7	Përcaktimi i Lagështisë	Copë/një testim	1	6500
8	Përcaktimi i Opacitetit	Copë/një testim	1	6900

Referuar informacionit dhe dokumentacionit sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik

Arsyeton

II.1. Referuar pretendimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK në ankesën drejtuar Komisionit Prokurimit Publik në lidhje me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, “Kristalina-KH” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK ndër të tjera pretendohet që “Duke qene se modelet e dorezuara nga firmat “Marketing & Distribution”, firma “Kristalina KH”, BOE “Office Paper” &

“Inpress” dhe “Infosoft Office”, ne kete tender nuk jane sipas specifikimeve teknike kerkojme te behet analiza e tyre, pra e kutise dhe e dosjes ne nje laborator te akredituar per:

1. Gramaturen,

2. pH-in,

3. Matjen e permasave fizike te modeleve, dhe gjithashtu matjen e hapësirave nga rreshti ne rresht, vijezimet, te percaktohet lloji i shkrimit, matja e kornizimit nga border line ne limitin e dosjes

4. Analizen per percaktimin e ngjyres.

KPP konstaton se për sqarimin e fakteve kërkohen njohuri të posaçme teknike dhe kryerja e veprimeve proceduralë për realizimin e analizave laboratorike të mostrave kuti dhe dosje kartoni të paraqitura në procedurën e prokurimit objekt ankimi, për një gjykim të drejtë dhe transparent të ankesës, KPP vlerëson të kryhet veprimi procedural i ekzaminimit dhe analizimit të komponentëve 1- Gramaturë, 2- pH, 3- Trashësi, 4- Volumi specifik dhe densitet, 5- Opecitet, 6- Lagështi, 7- Përmasat, të mostrave të operatorëve ekonomikë “Marketing & Distribution” SHPK, “Kristalina–KH” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK të administruara me shkresën nr. 3087/18 prot, datë 24.02.2026, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 3717/8 prot, datë 24.02.2026, si më poshtë:

- kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm)

- dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).

II.2. Për këtë qëllim Komisioni i Prokurimit Publik pas komunikimeve me laboratorin testues të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial SHPK, laborator i cili sipas përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, është i akredituar për kryerjen e analizave për 7 (shtatë) tregues, me shkresën nr. 2835/1 prot., datë 24.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 3717/17 prot, datë 25.03.2026 me objekt “Kthim-përgjigje”, laboratorin testues “Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial” SHPK, informon si më poshtë vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me Prot/hyrës Nr. 2835, datë 19.03.2026, ju bëjmë me dije se në Laboratorin e tekstileve pranë Inspektoriatit Shtetëror teknik dhe Industrial, kryhen testimet për letër/karton për këto tregues: 1- Gramaturë, 2- pH, 3- Trashësi, 4- Volumi specifik, 5- Densitet, 6- Opacitet, 7- Lagështi, 8- Përmasat. Të gjithë treguesit janë të akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit DPA. Kostot për testimin e një kampioni letër/karton, ku përfshihen të gjithë treguesit e sipër përmendur është 9000 (nëntëmijë) lekë”.

II.3. Në nenin 115, pika 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, “Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka nevojë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Afati për marrjen e vendimit nuk duhet të tejkalojë 30 ditë. Në çdo rast Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të vërë në dijeni palët.”

II.4. Në nenin 24 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikohet se:

1. Nëse gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës Komisioni vlerëson, se për sqarimin e fakteve kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës, teknologjisë ose artit, Komisioni mund të urdhërojë marrjen e mendimit të ekspertëve ose kryerjen e ekspertizës në laboratorë të specializuar.
2. Ekspertët përzgjidhen nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar. Në rast se për shqyrtimin e çështjes kërkohet ekspertizë e posaçme dhe nuk disponohet asnjë ekspert i fushës për të cilën nevojitet ekspertizë në listën e miratuar, mund të kërkohen rast pas rasti ekspertë të pavarur nga institucione të arsimit të lartë ose struktura të tjera të posaçme.
3. Komisioni njofton palët në proces për vendimin e ekspertimit, shpenzimet procedurale dhe datën e zhvillimit të seancës.

II.5. Në nenin 25 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, parashikohet se: “Kur Komisioni, në procesin e shqyrtimit të një ankese, urdhëron thirrjen e specialistëve ose të ekspertëve dhe kryerjen e ekspertizës, duhet të përcaktojë detyrimin e palëve për parapagimin e tyre dhe afatin.”

Sa më sipër në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligji Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 24, 25 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19 Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për ekzaminimin e mostrave të kutive dhe dosjeve të paraqitura nga operatorët ekonomikë “Marketing & Distribution” SHPK, “Kristalina-KH” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK nga laboratoritë e akredituar pranë Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi Kufirin e Lartë Monetar”, me Nr REF-65489-10-17-2025, me objekt “Blerje kuti dhe dosje për ruajtje të përhershme”, me fond limit 47,298,660 (dyzet e shtatë milion e dyqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, ose 489,077.24 (katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë njëzet e katër) euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 17.10.2025 është 96.71 lekë, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 20.11.2025 nga autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

2. Të testohen komponentët 1- Gramaturë, 2- pH, 3- Trashësi, 4- Volumi specifik dhe densitet, 5- Opecitet, 6- Lagështi, 7- Përmasat, të mostrave të operatorëve ekonomikë “Marketing & Distribution” SHPK, “Kristalina-KH” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK, për:
 - kuti për ruajtje të përhershme (40x28x18) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm)
 - dosje për ruajtje të përhershme (36x24) cm (Marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm).
3. Laboratori testues pranë *Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial*, të argumentojë në nivel teknik nëse në rezultatet e testimit, ndikon marzhi i gabimit të përmasave ± 3 mm, i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit.
4. Operatori ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK, ditën e dorëzimit të mostrave më datë 07.04.2026, të paraqitet pranë laboratorit testues të *Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial*, për tu pajisur me faturën me të dhënat bankare me qëllim kryerjen e pagesës për llogari të laboratorit testues pranë *Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial* sipas tarifave të përcaktuara me shkresën nr. 2835/1 prot., datë 24.03.2026, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga ky laborator dhe të bëra të ditura Komisionit Prokurimit Publik nëpërmjetë postës elektronike më datë 01.04.2026.
5. Operatori ekonomik ankimues “Adel Co” SHPK pas kryerjes së pagesës të vërë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare, brenda datës 09.04.2026 ora 12:00.
6. Në datë 07.04.2026, ora 12:00 të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të operatori ekonomik “Marketing & Distribution” SHPK, “Kristalina-KH” SHPK, BOE “Office Paper” SHPK & “Inpress” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK, “Adel Co” SHPK dhe përfaqësues të Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a për verifikimin e mostrave për të cilët ngrihen pretendimet dhe shoqërimin e tyre pranë laboratorit testues *Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial*.
7. Njoftojet laboratori testues pranë *Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial* për kryerjen e testimit të mostrave sipas kërkesave në këtë vendim.
8. Afati për kthimin e përgjigjes së testimit është brenda 5 (pesë) ditëve punë, nga dita e nesërme e marrjes në dorëzim të mostrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

